

**PROCESVERBAL**  
**PËR KONSULTIMIN PUBLIK PËR PBA-NË 2024-2026 DHE BUXHETIN VJETOR 2024,**  
**SI DHE PËR TAKSAT E TARIFAT VENDORE**

I mbajtur me datë 18.10.2023 në orën 17:00 në ambientet e Bar Restorant “Orkidea” në autostradë (në Njësinë Administrative Shënkoll) në vijim të njoftimit të publikuar në Web, përkatësisht në linkun <https://lezha.gov.al/konsultim-publik-per-pba-ne-2024-2026-buxhetin-vjetor-si-dhe-taksat-e-tarifat-vendore/>, me prezencën e panelit prej 7 anëtarësh:

1. Kryetarit të Bashkisë Lezhë-Z.Pjerin Ndreu,
2. Zv.Kryetarit të Bashkisë Lezhë-Z.Ermal Pacaj,
3. Zv.Kryetares së Bashkisë Lezhë- Znj.Eueda Molla,
4. Kryetarit të Këshillit Bashkiak Lezhë -Z.Ndue Luli,
5. Administratori i Njesisë Administrative Shënkoll-Z.Ernest Rakaj,
6. Administratori i Njesisë Administrative Zejmen- Z.Leonard Perjaku,
7. Administratori i Njesisë Administrative Kolsh-Z.Fatjon Zefi,

drejtorit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe kryetarë të fshtreve, banorë dhe përfaqësues të bizneseve nga njësitë administrative Shënkoll, Zejmen dhe Kolsh.

Takimi u hap nga Kryetari i Bashkisë i cili vendosi theksin në temën e takimit duke pritur sygjerime, propozime nga komunitetet e tre njësive administrative për projekt buxhetin, buxhetin dhe paketen fiskale 2024. Sipas tij buxheti nuk është asnjëherë i mjaftueshëm por duke e shtrirë ndër vite mund të evidentohen nevojat e domosdoshme, rast pas rasti. Ky është edhe qëllimi i këtyre takimeve, që të identifikohen nga afër problematikat dhe të parashikohen nderhyrjet përkatëse. Një element i rëndësishëm që duhet patur parasysh është raporti i investimeve të bashkisë me taksat që paguajnë banorët e këtyre njësive administrative i cili është në vlera negative.

Në Njësinë Shënkoll, duke përfshirë ndërhyrje në ujësjellës, varreza, rrugë etj. për 4 vite janë bërë rreth 11 miliard lekë (të vjetra) investime ndërsa derdhja e kuotave është 77 milion lekë ose 6.8%. Bashkia është administrator i lekëve dhe nëpërmjet pagesës së taksave rritet edhe transparenca në raportimin e shpenzimeve.

Në Njësinë Zejmen janë bërë 377 milion investime dhe janë mbledhur rreth 12% taksa në raport me shpenzimet.

Në Njesinë Kolsh janë bërë 52 milion investime dhe janë mbledhur 16.8 % taksa në raport me shpenzimet.

Kryetari u shpreh se me këtë nivel taksash, përfshirë edhe abuzimet e bëra më përpara me numër të lartë të punësuarish, pandeminë, krizen ekonomike etj. menaxhimi ka qenë shumë i vështirë. Bashkia Lezhë nuk ka operuar me rritje taksash, madje është një ndër bashkitë me taksat më të ulëta por synohet zgjerimi i bazës së taksapaguesve, duke përfshirë edhe taksapaguesit familjarë. Gjithashtu u theksua që do të ketë një sistem vetëdeklarimi, formular dhe nëse ka deklarata të rrema do të ketë penalizime. Kjo do të shërbejë për të krijuar një bazë të dhënash për të mundësuar një taksim sa më të drejtë. Me sistemin elektronik secili do ketë mundësi të ketë llogarinë e vet. Është evidentuar se bizneset me sipërfaqe të ndryshme kanë paguar të njëjtat taksa dhe pasi janë reflektuar ndryshimet në matje disa biznese janë ankuar për rritje taksash por në fakt taksimi nuk ka ndryshuar. Për lokalet e dasmave do të shtohet pagesa për shkak se janë ndër ndotësit më të mëdhenj të mjedisit. Do të instalohen sistem kamerash dhe do të ketë penalizime për ndotësit. Në rrugën e Rilë-Hidrovor e cila në dakordësim me Kryeministrin është një rrugë që do të bëhet, kanalet përreth janë të ndotura. Brenda janarit do të hiqen koshat dhe do të ketë një orar për grumbullimin e mbeturinave, 2-3 herë në javë, pika të përcaktuara ku do të shkojë makina e pastrimit për ti marrë.

Në fjalën e tij kryetari theksoi që nuk do ketë rritje taksash por do të rritet intensiteti për grumbullimin e tyre. Formula e vetëdeklarimit parashikohet të dalë shumë shpejt. Nëpërmjet mbledhjes së taksave do të ketë edhe më shumë investime. Në zonën e bregdetit, projekti nga Lumi i Matës deri në Barbullojë, Shëngjin, do të nxisë më tepër zhvillimin e turizmit. Një problem është çështja e varrezave, por ato nuk administrohen nga Bashkia Lezhë. Nëpërmjet pagesës së një tarife për këtë shërbim do të ngritet një grup i cili do të merret me mirëmbajtjen e varrezave, përkatësisht për secilen njësi administrative. Propozohet një marrëdhënie më e fortë ndërmjet bashkisë dhe banorëve duke treguar përgjegjshmëri për pagesën e taksave.

Fjalën e mori tek drejtori i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për prezantimin e situatës së taksave në këto 3 njësi administrative. Regjistri i taksapaguesve përbëhet nga biznesi, familjarët, pronarët posedues që japin godinat për qëllime ekonomike. Gjatë prezantimit u evidentua që numri total i familjeve të zonës është 9858 familje nga të cilat 554 kanë kontratë me ujësjellësin, pjesa tjetër pagujnë në njësitë vendore. Të ardhurat totale që grumbullohen në këtë zonë janë 67 milion lekë (të vjetra) ndërsa kapaciteti në këtë zonë shkon në 460 milion lekë (të vjetra). U theksua që qëllimi i paketës fiskale është taksimi sa më i drejtë, të mos ketë rritje taksash/tarifash por të zgjerohet numri i taksapaguesve dhe të krijohet një regjister elektronik për gjithë taksapaguesit familjarë.

Shembull për një familje mesatare me një shtëpi me 150 m<sup>2</sup> dhe truall 300 m<sup>2</sup> ka një total 4,688 lekë të reja në vit, së bashku me pagesë ndriçimi, pastrimi, varrezash. Përfshihen nga pagesat familjet në nevojë, pensionistët dhe banesat sociale.

Shembull për një biznes të vogël me 100 m<sup>2</sup> ndërtesë do të paguante në total 19,300 lekë të reja në vit ndërsa biznesi i madh do të paguante 393,900 lekë të reja në vit. Vetëdeklarimi i pronës është një element shumë i rëndësishëm për bizneset. Sot janë 170 biznese të zonës që nuk kanë dorëzuar dokumentacion mbi pronësinë. Lehtësirat fiskale do të jenë depozitimi i dokumentave në mënyrë digjitale, aksesit digjital në sistemin e taksave. Masat që do të merren për biznesin është depozitimi i dokumentave të pronësisë deri me 31 Janar, më pas do të kalojë me penalitet financiar.

Kryetari deklaroi se përveç kompetencave që i takojnë pushtetit vendor do të bëjë edhe ndërmjetësin për referimin e problemeve të komunitetit me OSHEE-në, shëndetësinë etj. tek pushteti qëndror, gjithashtu shprehu gadishmërinë për të qënë pranë komunitetit me takime nëpër fshatra, njësi për njësi.

## **Mendime/Diskutime**

**1. (Kryetari i fshatit Shënkoll)** shprehu si domosdoshmëri pagesën e taksave për familjarët, ashtu siç paguan edhe biznesi. Parashtrioi tre faza për këtë proces. Në fazën e parë kryetari i fshatit, së bashku me administratorin të mundësojë një takim në bashkëpunim me përfaqësues të bashkisë. Në fazën e dytë të bëhet informimi me zarfa me afat të përcaktuar për pagesën dhe në fazën e tretë të ndërmerren gjopa për ata që nuk paguajnë në kohë.

Në vijim të këtij diskutimi kryetari theksoi se duke qënë se të dhënat që disponon Bashkia për bizneset/familjarët nuk janë të plota do të procedohet me sistem vetëdeklarimi.

**2. (Kryetari i fshatit Zejmen)** ngriti si shqetësim zgjerimin e varrezave të Zejmenit si dhe disa rrugë të lagjes të cilat janë problem për fëmijët që kalojnë aty.

Në përgjigje të këtij shqetësimi kryetari u shpreh se Bashkia do vazhdojë punën me rrugët rurale në bashkëpunim me administratorët, kryetarët e fshatarave duke analizuar edhe hartën digjitale me qëllim që të evidentohen kryesisht zonat që kanë më shumë përfitues ose që janë pika të rëndësishme potenciale zhvillimi. Një shembull ishte projekti i rrugës së Velës i cili do t'i jepte zhvillim zonës dhe do kthehej në një pikë turistike.

**3. (Kryetari i fshatit Tresh)** përmendi si shqetësim ujësjellësin e fshatit dhe sygjeroi që të bëhet lidhja e kontratave familjare duke mundësuar mbledhjen e taksave në faturat e ujit. Problemi tjetër

ka të bëjë me rrugët e fshatit dhe për secilën rrugë është evidentuar numri i familjeve përfituese, të gjitha këto rrugë përbëjnë në total 800 metra.

Për Njësinë Zejmen, kryetari theksoi që ujësjellësi do të jetë sipas parametrave të përcaktuara ose në rast të kundërt nuk do të merret në dorëzim. Për rrugët e Treshit janë parashikuar investime.

**4. (Kryetari i Fshatit Tale 1)** ngriti si problem kryesor kanalet kulluese. Në lagjen te Ura nevojiten specialistë, topografë për të bërë ndërhyrje sepse urat nuk janë sipas parametrave dhe kanalet nuk janë në kuotat e duhura. Problemi tjetër ka të bëjë me ujësjellësin, ku rruga kryesore është çarë në 15 vende duke u bërë shqetësues për makinat që kalojnë dhe kanali kullues kryesor ku kanë kaluar tubacionet e ujësjellësit kanë prishur 3 tuba urash.

Në vijim të diskutimit kryetari u shpreh se stafi i Drejtorisë së Bujqësisë ka evidentuar në terren numër shumë të lartë urash në Bregun e Matës dhe kjo mund të jetë problematike në raste përmbytjesh, sidomos kur situata agravon shumë shpejt me reshje intensive. Bashkia ka bërë mbi 500 km kanale kulluese dhe do të vijojë procedurat për të blerë mjetet e nevojshme të punës në funksion të pastrimit tyre, madje është në negociata edhe me Ambasadën Japoneze. Vëmendja e investitorëve të mëdhenj në zonën turistike të Lezhës është në kurbën më të lartë.

**5.(Banor në fshatin Barbullojë e Re)** shtroi si problem pastrimin e kanaleve në zonën Barbullojë e Re si dhe problematika me tre rrugë të zonës, njëra 50 metra, tjetra rruga e Marka Laskës dhe e treta rruga e shkollës e cila është lënë përgjysëm.

Në përfundim të diskutimeve, takimi u mbyll nga Kryetari i Bashkisë Lezhë.

Kohëzgjatja: Rreth 70 minuta

Pjesëmarrës: 91 persona Femra: 13

**Drejtori i Drejtorisë së Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diaspores, Komunikimit dhe Transparencës**

Elson Frroku



**Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik**

Gjystina Nik-ulaj



**Drejtorja e Financës dhe Buxhetit<sup>1</sup>**

Xhemal Haxhia



**<sup>1</sup> Shënime:**

- Numrat rendor (1,2,3,..) tregojnë numrin dhe radhën e personave të cilët kanë diskutuar gjatë konsultimit. Në kllapa janë shënuar emrat/inicialet apo zona/ kategoria që përfaqësojnë.
- Theksojmë se procesverbali është hartuar kryesisht mbi bazën e perifrazimeve dhe përmbledhjes. Në pjesën e parë të procesverbalit në çdo paragraf paraqiten perifrazime sipas radhës së prezantimeve. Në pjesën e dytë, parashtrihen fillimisht sygjerimet/mendimet nga audienca dhe pastaj sipas rasteve replika përkatëse.



